

VENDIM
Nr. 944, datë 9.10.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shetëtorë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shetëtorë të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit harton dhe zbaton politika që synojnë modernizimin e zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban, strehimit, legalizimit e integritit të ndërtimeve informale dhe turizmit.

III. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shetëtorë në përputhje me legjislacionit përkatës:

1. Fushën e planifikimit e të zhvillimit urban, administrimit të tokës dhe zhvillimit të qëndrueshëm e kontrollit të territorit.

2. Fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

3. Fushën e strehimit.

4. Fushën e legalizimit e të integritit të zonave dhe ndërtimeve informale.

5. Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial.

IV. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, të strategjive e të politikave në fushat e përgjegjësisë shetëtorë që mbulon.

V. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama